



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:283452

Datë: 24.01.2025

Numri i dokumentit: 06755482

ARJ.nr.152/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Delushe Halimi kryetare, Ragip Namani dhe Rustem Thaqi anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit D.P.Z “D. P.” me seli në P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i aktit administrativ - vendimit të paditurës nr.07.3/1058/2015, të datës 31.07.2019, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1192/22, të datës 13.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23 janar 2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi D.P.Z “D. P.” me seli në P., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1192/22, të datës 13.11.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1192/22, të datës 13.11.2023, është vendosur si në vijim: Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit, D.P.Z “D. P.” me seli në P., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2112/19, të datës 02.11.2021, Vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1192/22, të datës 13.11.2023, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të ANULOHET Aktgjykimi

i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr.1192/22, të datës 13.11.2023, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2112/19 të datës 02.11.2021, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala e paditur.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurës Dogana e Kosovës, nr. 07.3/1058/2018 të datës 30.10.2015, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, D.P.Z “D. P.” me seli në P., të ushtruar ndaj aktvendimit nr.05.1/618 të datës 12.10.2015, të Sektori për Kontroll Pas Importues, si e pa bazuar.

Kundër vendimit të lartë cekur të paditurës Dogana e Kosovës, paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.2112/19 të datës 02.11.2021, ka vendosur si në vijim: refuzuar si e pabazuar kërkesëpadi e paditësit D.P.Z “D. P.” me seli në P., ndërsa është lënë në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës nr.07.3/1058/2015, i datës 31.07.2019.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Nga provat shkresore të administruara në këtë konflikt administrativ, del se e paditura Dogana e Kosovës - Sektori i Kontrollit Pas Importues duke vepruar sipas detyrës zyrtare, me datë 09.10.2015, ka iniciuar kontrollin dokumentar ndaj paditësit, nën dyshimin se nuk e ka tarifuar saktë mallin e importuar me DUD-at kontestues. Si rezultat i kësaj e paditura Sektori i Kontrollit Pas Importues duke u bazuar edhe në Mendimin për Klasifikimin Tarifor nr.69 për mallrat identike me mallrat e zhdoganuara nga këtu paditësi me DUD-at kontestues, të dhënë nga Sektori Tarifave, i cili vepron në kuadër të paditurës, ka ardhur në përfundim se paditësi me DUD-at kontestues nga data 22.03.2014 deri më 20.07.2015, me rastin e zhdoganimit nuk i ka deklaruar saktë kodet tarifore të mallit në rubrikën 33 të DUD-ave kontestues, ngase mallin e deklaruar për zhdoganim e ka deklaruar me numrin kodin tarifor ..., numër ky i cili e ka liruar mallin nga taksa doganore prej 10% ndërsa sipas Sektorit të Tarifës pranë të paditurës bazuar edhe në Mendim për Klasifikimin Tarifor si më lartë është dashur të tarifohet në numrin kodin tarifor ..., me përshkrim të mallit *“profile kanat të valëzuara alumini me bërthamë poliuretan, të mbushura me poliuretan”*, sipas të cilit numër për mallin e deklaruar duhet të paguhet taksa doganore prej 10% në vlerë prej 36,692.74€ dhe diferenca e TVSh-së në shumë prej 5,919.97€, apo gjithsej taksa doganore prej 42,612.71€. Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga

ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Andaj, në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Komerciale-Dhomat e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së, nenit 81.H të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Në arsyetim të aktgjykimit të saj ndër të tjera thekson se: Kolegji vlerëson se Organi administrativ, në rastin konkret Dogana e Kosovës, në bazë të nenit 82 të KDA, i cili përcakton se: *“1. Dogana sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të deklaruesit e rishqyrton deklaratën pas lirimimit të mallit. 2. Dogana, pasi ta ketë lejuar lirimin e mallrave dhe më qëllim që të sigurohet për të dhënat e vërteta të deklaruara, në deklaratën doganore, mund të kontrollojë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë të bëjnë me importin apo eksportin, si dhe veprimet pasuese (të mëvonshme) tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky kontroll mund të kryhet në ambientet e deklaruesit ose të çdo personi, drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfshirë në veprimet e mësipërme për arsye të veprimtarisë së tij ose të çdo personi tjetër në posedimin e të cilit janë dokumentet e lartshënuara për qëllime tregtie. Dogana, po ashtu mund të kontrollojë edhe mallrat kur paraqitja e tyre është ende e mundur. 3. Pa rënë ndesh me nenin 219.3 kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota, Dogana, në përputhje me dispozitat në fuqi, do të ndërmerr masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar, duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion”*, ka vlerësuar se paditësi nuk ka ofruar provat relevante gjegjësisht informatën detyruese tarifore nga vendi eksportues dhe i origjinës së mallit, sqarime nga prodhuesi, për Deklaratat Doganore kontestuese, për të vërtetuar pretendimin se vërtet malli lëndor klasifikohet në kodin tarifor siç janë deklaruar nga paditësi dhe jo ashtu siç janë ndryshuar nga e paditura me aktvendimin kontestues.

Gjykata ka konstatuar se deklarata eksportuese përpilohet nga agjenti doganor mbi bazën e të dhënave nga fatura përcjellëse e mallit për qëllime doganore nga shteti eksportues dhe se e njëjta nuk paraqet dëshmi për referim të saktë të numrit kodit tarifor ngase bazuar në dispozitën e nenit 24 të KDA-së ku thuhet se: *“Detyrimet e importit për tu paguar ligjshëmish kur lind një borxh doganor, bazohen në nomenklaturën e TARIK-u, Tarifës Doganore Kosovë dhe çdo marrëveshje me një vend tjetër apo grup vendesh, ku hyn edhe Kosova kur merren masa për lejimin e trajtimit*

preferencial tarifor”, përcaktojnë aplikimin e TARIK-ut të Kosovës, gjithmonë përderisa nuk kemi informatë tarifore detyruese për mallin konkret nga BE-ja apo autoriteti doganor i shtetit eksportues të mallit.

Lidhur me pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore, si dhe theksimet e tjera në përshkrim të ankesës, gjykata ka theksuar se të njëjtat i ka refuzuar si të pa bazuara dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, në referim të nenit 24 par.1 të KDA-së. E paditura Dogana e Kosovës pas marrjes të Mendimeve për Klasifikim Tarifor nga Sektori i Tarifës dhe deri tek ky konstatim ka ardhur duke u bazuar në rregullat e përgjithshme numër 1-6 për interpretimin e TARIK-2014, e në bazë të shënimeve shpjeguese të seksionit XV, kapitullit 76, shpjegimeve plotësuese për krerët përkatës, fotove të dërguara, informatave nga interneti si dhe informatave tjera.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Andaj, në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimi të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës, vlerëson se dhomat e shkallës së dytë kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë me që aktgjykimet e kontestuar nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuar përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pa bazuar të kërkesëpadsisë së paditësit.

Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimi të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të paditurës Dogana e Kosovës, nr. 07.3/1058/2018 të datës 30.10.2015, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, D.P.Z “D. P.” me seli në P., të ushtruar ndaj aktvendimit nr.05.1/618 të datës 12.10.2015, të Sektori për Kontroll Pas Importues, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Pretendimet e paditësit, të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, se e paditura nuk ka interpretuar drejtë nenin 219.3 të KDAK, dhe 82.3, përkatësisht se nuk ka vepruar sipas nenit 72.b, dhe se sektori i tarifës nuk ka bazë ligjore për dhënien e mendimit për klasifikimi tarifor, konform nenit 9 pika 1.4 të UA 11/2013, por kjo i takon sektorit të laboratorit, dhe mendimi i dhënë nuk është në pajtim me nenin 72 dhe 265, pasi nuk është dhënë për paditësin por për një subjekt tjetër, se e paditura nuk ka marrë parasysh

deklaratën eksportuese ku ceket kodi tarifor, se lidhur me këtë çështje ka vendosur e njëjta gjykatë me aktgjykimin A.nr.2128/15, me të cilin është aprovuar kërkesëpadsisë e paditësit ndërsa është anuluar vendimi i të paditurës, kolegji i Gjykatës Supreme, i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzoi në tërësi si të pabazuara.

Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësi as pranë organit të administratës dhe as pranë gjykatës, nuk ka arritur që të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar me vendimin kontestues, dhe nga dëshmitë e parashtruara nuk mund të vërtetohet e kundërta e asaj që është vërtetuar nga vendimi i kontestuar.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkelje të dispozitave të procedurës apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale, vlerësoj se këto pretendime janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për një vendosje ndryshe në këtë çështje nga çka kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë.

Nga gjendja si më lartë rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, KDAK-së. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe me të drejtë kanë vlerësuar se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit.

Nga se u theksua si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.152/2024, më datë 23 janar 2025

B. Profesionale
Zanë Buçinca

Kryetare e Kolegjit
Delushe Halimi